



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve 6.1 e 40 të Rregullores së Kuvendit, në seancë të jashtëzakonshme, të mbajtur më 11 dhe 12 tetor 2016, pas debatit parlamentar lidhur me arrestimin e zotit Nehat Thaçi, njëherësh epror i Policisë së Republikës së Kosovës, nga autoritetet e Serbisë, nxori këtë:

REZOLUTË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirimin e menjëhershëm të zotit Nehat Thaçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës.
2. BE-ja, si ndërmjetësues dhe garantues i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nëpërmjet mekanizmave të saj detyruet të ndërhyjë te Qeveria e Serbisë që të lirohet eprori Nehat Thaçi.
3. Çdo komunikim i Qeverisë së Republikës së Kosovës për rastin e arrestimit të zotit Nehat Thaçi, deri në lirimin e tij, të bëhet vetëm nëpërmjet Zyrës së znj. Federica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe zv./presidente e Komisionit Evropian.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës t'ia bëjë me dije BE-së se veprimet e tilla të Serbisë në raport me institucionet dhe qytetarët e Kosovës po e rrezikojnë thellë përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe dialogun ndërmjet dy vendeve, duke na detyruar në reciprocitet.
5. Misioni i EULEX-it të deklarohet për rastin e zotit Thaçi dhe njëherësh kërkojmë angazhim të drejtpërdrejtë si mision me kompetenca të veçanta.
6. Kërkojmë nga Interpoli që Policia e Kosovës të bëhet pjesë e kësaj organizate dhe njëherësh insistojmë që fletë-arrestet politike të shpallura nga Serbia të largohen nga sistemi i tyre ligjor.

Nr. 05-R-05
Prishtinë, më 12 tetor 2016

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

CC:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë,
- Arkivit të Kuvendit.